



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Nr. 8546 prot.

Himarë, më 20.11. 2025

Lënda: Dërgohet projektvendimi dhe relacioni shpjegues mbi themelimin e “Klubi i Sportit Himara”.

KËSHILIT TË BASHKISË HIMARË
SEKRETARISË SË KËSHILLIT BASHKIAK

KËTU

Në mbështetje të; Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", Ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", shkronjës "c" të pikës 1.5 shkronjës "b" të pikës 1.6, të nenit 9, shkronjës "d" të nenit 54, shkronjës "g" të nenit 64 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit Nr. 105/2020 , "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 79/2017 "Për sportin", nenet 9, 10, 12, 16, 17 të Ligjit Nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, Ligjit Nr. 80/2021, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", nenet 39 – 52 të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994, "Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- 1- Projektvendimin për themelimin e shoqatës sportive jofitimprurëse **“Klubi i Sportit Himara”**, dhe miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”.
- 2- Relacionin shpjegues për të.
- 3- Projekt –**“Akti Themelimi”** dhe **“Statuti”**.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË
Vangjel TAVO

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

KTYETARI

Nr. 8546/prot.

Himarë, më 20.11. 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. 61, Datë 20.11/2025

PËR:

“THEMELIMIN E SHOQATËS SPORTIVE JOFITIMPRURËSE “KLUBI I SPORTIT HIMARA”, MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT DHE STATUTIT”

Në mbështetje të; Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", Ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", shkronjës "c" të pikës 1.5 shkronjës "b" të pikës 1.6, të nenit 9, shkronjës "d" të nenit 54, shkronjës "g" të nenit 64 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit Nr. 105/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 79/2017 "Për sportin", nenet 9, 10, 12, 16, 17 të Ligjit Nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, Ligjit Nr. 80/2021, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", nenet 39 – 52 të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994, "Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe bazuar në relacioni i paraqitur dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë;

**KËSHILLI I BASHKISË
VENDOSI :**

1. Të miratojë themelimin e Shoqatës Sportive Jofitimprurëse “Klubi i Sportit Himara”, sipas kërkesave të nenit 6 të Ligjit Nr. 105/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 79/2017 "Për sportin".”
2. Të miratojë aktin e themelimit dhe statutin e shoqatës, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
3. Për zbatim të këtij vendimi dhe regjistrimin e shoqatës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Administrata e Bashkisë Himarë dhe organet e shoqatës.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të Prefektit të Qarkut Vlorë, sipas legjislacionit në fuqi.

DREJTORI I DREJTORISË SË TURIZMIT,
KULTURËS DHE SPORTIT
Uran Dulaj

DREJTOR I FINANCËS DHE
PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT
Besa Xhaferi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E TURIZMIT, KULTUTRËS DHE SPORTIT

Nr. 8546/2 prot.

Himarë, më 20.11.2025

RELACION PËR PROJEKT- VENDIMIN ME OBJEKT
PËR
“THEMELIMIN E SHOQATËS SPORTIVE JOFITIMPRURËSE “KLUBI I SPORTIT
HIMARA”, MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT DHE STATUTIT”.

I NDERUAR KRYETARI I KËSHILLIT !
TË NDERUAR KËSHILLTARË !

KREU I
HYRJA DHE PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË:

Qëllimi i krijimit të kësaj shoqate është zhvillimi i aktivitetit sportiv , rritja e vlerave sportive, duke zbuluar elemente të talentuar dhe përgatitja e tyre për të ardhmen e sportit në përgjithësi. Veprimtaria e kësaj organizate jo qeveritare, jopolitike ,jopartake, jofetare, është e pavarur, nuk ndjek qëllime ekonomike dhe nuk është organizate fitimprurëse. Organizata jo fitimprurëse e konsideron veten kryesisht jashtë çdo lloj çështjeje apo ndërhyrjeje raciale, fetare, politike etj.

Shoqata do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Të nxisë dhe të mbështesë veprimtaritë sportive profesioniste dhe amatore.
2. Organizimi i aktiviteteve sportive në rang kombëtar .
3. Krijimi i strukturave mbështetëse sportive për të gjitha grupmoshat .
4. Promovimi i aktiviteteve sportive dhe iniciativave për zhvillimin e sportit .
5. Mbrojtja e interesave dhe të drejtave të shoqatës.
6. Të synojë bashkëpunimin me shoqata të tjera të të njëjtë lloj.
7. Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare sipas disiplinave dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve sportive në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.
8. Futja në tregun e lojtarëve sipas nevojave të ekipit.
9. Aktivitete të tjera në fushën e sportit për interesat e Shoqatës dhe Bashkisë.

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licensat apo lejet përkatëse .

KREU II
INTERPRETIMI I BAZËS LIGJORE

Referuar pikës 1.5 të nenit 9 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.5. Të drejtën e bashkëpunimit, sipas së cilës:

c) kanë të drejtë të organizohen në shoqata, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Gjithashtu shkronja "d" e nenit 54 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, parashikon se, është Këshilli i Bashkisë ai që:

- miraton aktin e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose me të cilët është bashkëthemelues.

Për sa më sipër, duke krijuar bindjen që projekt vendimet janë në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore dhe se dokumentacioni shoqëruar është i plotë, Jeni të lutur të miratoni projekt vendimet bashkëngjitur.

Duke shprehur në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

PËRGATITI MATERIALIN:

**DREJTORI I DREJTORISË SË TURIZMIT,
KULTURËS DHE SPORTIT**

Uran Dulaj



**DREJTOR I FINANCËS DHE
PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT**

Besa Xhaferi



**MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
VANGJEL TAVO**

ME URDHËR DHE DELEGIM

ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 8546/3 prot.

Himarë, më 20.11 . 2025

AKT-THEMELIMI

PËR KRIJIMIN E SHOQATËS SPORTIVE JOFTIMPRURËSE “KLUBI I SPORTIT HIMARË”

Në qytetin e Himarës, sot me datë _____. 2025, në ambientet e Bashkisë Himarë, u zhvillua mbledhja e anëtarëve themelues të kësaj shoqate, të poshtëshënuar dhe pasi u ballafaquan me;

Ligjin Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, shkronjën "c" të pikës 1.5 shkronjën "b" të pikës 1.6, të nenit 9, shkronjës "d" të nenit 54, shkronjës "g" të nenit 64 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenin 6 të Ligjin Nr. 105/2020 , "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 79/2017 "Për sportin"", nenet 9, 10, 12, 16, 17 të Ligjit Nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", Ligjin Nr. 80/2021, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", nenet 39 – 52 të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994, "Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSËN:

Të hartojnë këtë Akt – Themelimi, për krijimin e shoqatës sportive jofitimprurëse “Klubi i Sportit Himara”, me përmbajtje si më poshtë:

Bashkia Himarë, e përfaqësuar nga:

1. Z. Vangjel TAVO, Kryetari i Bashkisë.
2. Znj. Erifili Berberi, Nënkyetar i Bashkisë.
3. Z. Pervin Gjiguria, Sekretar i Përgjithshëm
4. Znj. Besa Xhaferi, Drejtor I Drejtorisë së Financës dhe Planifikimit të Buxhetit
5. Z.Uran Dulaj, Drejtor i Drejtorisë se Turizmit, Kulturës dhe Sportit
6. Z.Thimjo Gjinuci, Administrator i Njësisë Administrative Himarë

NENI 1

THEMELIMI

Themeluesi , Bashkia Himarë, krijon Klubin e Sportit Himarë, në formën e një shoqate.

Themeluesi i shoqatës është Bashkia Himarë, nëpërmjet personave të punësuar pranë saj, si dhe personave të tjerë fizikë që dëshirojnë të kontribuojnë për zhvillimin e veprimtarisë sportive.

Shoqëria do ta ketë selinë e saj në Himarë, pranë stadiumit "Petro Ruci", Himarë, me kod postar 9425.

NENI 2

QËLLIMI I KRIJIMIT TË SHOQATËS

Qëllimi i krijimit të kësaj shoqate është zhvillimi i aktivitetit sportiv , rritja e vlerave sportive për sportin , duke zbuluar elemente të talentuar dhe përgatitja e tyre për të ardhmen e sportit në përgjithësi. Veprimtaria e kësaj organizate jo qeveritare, jopolitike, jopartake, jofetare, është e pavarur, nuk ndjek qëllime ekonomike dhe nuk është organizate fitimprurëse. Organizata jo fitimprurëse e konsideron veten kryesisht jashtë çdo lloj çështjeje apo ndërhyrjeje raciale, fetare, politike etj.

NENI 3

EMRI, LOGO DHE VULA E SHOQËRISË

Shoqata do të dalë në qarkullim juridiko-civil me emrin KLUBI I SPORTIT HIMARA, shkurtimisht "K.S HIMARA".

Shoqëria do të ketë logon dhe vulën e saj.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Veprimtaria e Shoqatës do të jetë:

1. Të nxisë dhe të mbështesë veprimtaritë sportive profesionist dhe amator.
2. Organizimi i aktiviteteve sportive në rang kombëtar .
3. Krijimi i strukturave mbështetëse sportive për të gjitha grupmoshat .
4. Promovimi i aktiviteteve sportive dhe iniciativave për zhvillimin e sportit .
5. Mbrojtja e interesave dhe të drejtave të shoqatës.
6. Të synojë bashkëpunimin me shoqata të tjera të të njëjtit lloj.
7. Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare sipas disiplinës dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të sportit kombëtar dhe ndërkombëtar.
8. Futja në tregun e lojtarëve sipas nevojave të ekipit.
9. Aktivitete të tjera në fushën e sportit për interesat e Shoqatës dhe Bashkisë.

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licensat apo lejet përkatëse .

NENI 5

SELIA E SHOQATËS DHE AFATI I VEPRIMTARISË

Selia e Shoqatës do të jetë në Himarë, pranë stadiumit "Petro Ruci", Himarë, me kod postar 9425.

Shoqata zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të papërcaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Gjykatë, kohë nga e cila ajo fiton dhe personalitet juridik.

NENI 6

BURIMET FINANCIARE

Burimet financiare dhe materiale të Shoqatës janë:

1. Kuotizacionet e anëtarëve.
2. Mbështetje financiare nga shteti, Bashkia dhe Shoqëritë Aksionere me ortak të vetëm Bashkinë Himarë.
3. Mbështetje financiare nga Federatat Shqiptare.
4. Mbështetje financiare nga federatat ndërkombëtare dhe federate të tjera homologe.
5. Grante, donacione dhe sponsorizime të ofruara nga subjekte private dhe publike, vendas dhe të huaj.
6. Të ardhura nga reklamat.

7. Të ardhura nga veprimtaria ekonomike në përputhje me ligjin, sipas miratimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.
8. Të ardhura nga pasuritë në pronësi të Shoqatës.
9. Burime të tjera të ligjshme financiare.

NENI 7

KOHËZGJATJA E SHOQATËS

Veprimtaria e shoqatës do të shtrihet për një periudhë kohe të papërcaktuar.

Shoqata fiton cilësinë e personit juridik me karakter jofitimprurës që nga data e regjistrimit në gjykatë

NENI 8

ORGANET DREJTUESE

Organet e shoqatës janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve;
- Bordi drejtues
- Kryetari;
- Sekretari .

Të gjitha organet e zgjedhura të shoqatës qëndrojnë në detyrë për tre vjet dhe mund të rizgjidhen.

II. Anëtarët themelues, miratojnë Bordin e parë drejtues.

Shoqata do të përfaqësohet me marrëdhëniet e saj me të tretë nga Kryetari dhe me autorizim të Kryetarit edhe nga Sekretari.

NENI 9

MIRATIMI I AKTIT TË THEMELIMIT DHE STATUTIT

Anëtarët themelues miratojnë unanimisht Statutin dhe Aktin e Themelimit.

NENI 10

REGJISTRIMI I SHOQATËS SI PERSON JURIDIK

Anëtarët themelues autorizojnë “Sekretarin e Shoqatës”, për të ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për regjistrin e Shoqatës “KLUBI I SPORTIT HIMARA”, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në Tiranë, duke përgatitur, nënshkruar e paraqitur çdo dokument të nevojshëm për realizimin e këtij qëllimi.

Ky Akt Themelimi u përgatitet në 5 (Pesë) kopje origjinale, nga 3 (Tre) fletë secili, në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë ligjore, për përmbajtjen e të cilit anëtarët kanë rënë dakord dhe zotoben për zbatimin me besnikëri të tij.

ANËTARËT THEMELUES (emrat dhe firmat e tyre)

1. Z. Vangjel TAVO, Kryetari i Bashkisë. _____
2. Znj. Erifili Berberi, Nënkyetar i Bashkisë. _____
3. Z. Pervin Gjikutria, Sekretar i Përgjithshëm _____
4. Z. Thimjo Gjinuci, Administrator i Njesisë Administrative Himarë _____

4. Znj. Besa Xhaferi, Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Planifikimit të Buxhetit _____

5. Z.Uran Dulaj, Drejtor i Drejtorisë se Turizmit, Kulturës dhe Sportit _____

6. Z.Thimjo Gjinuci, Administrator i Njësisë Administrative Himarë _____



STATUTI
I SHOQATËS SPORTIVE JOFITIMPRURËSE
“KLUBI I SPORTIT HIMARA”

Në qytetin e Himarës, sot me datë _____. _____. 2025, në ambientet e Bashkisë Himarë, pasi u zhvillua mbledhja e anëtarëve themelues të kësaj shoqate, pasi u ballafaquan me;

Ligjin Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, shkronjën "c" të pikës 1.5 shkronjën "b" të pikës 1.6, të nenit 9, shkronjës "d" të nenit 54, shkronjës "g" të nenit 64 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenin 6 të Ligjit Nr. 105/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 79/2017 "Për sportin", nenet 9, 10, 12, 16, 17 të Ligjit Nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", Ligjit Nr. 80/2021, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", nenet 39 – 52 të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994, "Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pasi vendosën të themelojnë këtë shoqatë, vendosën gjithashtu të hartojnë dhe miratojnë statutin e shoqatës sportive jofitimprurëse "Klubi i Sportit Himara", me përmbajtje si më poshtë:

KAPITULLI I
FORMA LIGJORE, EMËRTIMI, SELIA E SHOQATËS
NENI 1

FORMA JURIDIKE

Në mbështetje të vullnetit të anëtarëve themelues të shprehur në aktin e themelimit si dhe në pajtim të plotë me dispozitat e; Ligjit nr. 79/2017 "Për sportin", Ligjit Nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", Ligjit Nr. 8789, datë 7.5.2001, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", nenet 39 – 52 të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994, "Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari, u themelua shoqata sportive jofitimprurëse "Klubi i Sportit Himarë", i cili do të funksionojë sipas dispozitave të aktit të themelimit dhe këtij statuti.

Shoqata u themelua me vullnetin e lirë nga:

Bashkia Himarë, e përfaqësuar nga:

1. Z. Vangjel Tavo, Kryetari i Bashkisë
2. Znj. Erifili Berberi, Nënkyetar i Bashkisë
3. Z. Pervin Gjikuria, Sekretar i Përgjithshëm
4. Znj. Besa Xhaferi, Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Planifikimit të Buxhetit
5. Z.Uran Dulaj, Drejtor i Drejtorisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit
6. Z.Thimjo Gjinuci, Administrator i Njesisë Administrative Himarë

NENI 2
EMËRTIMI

Shoqata do të dalë në qarkullim juridiko-civil me emrin Klubi i SPORTIT Himara, shkurtimisht "K.S HIMARA".

NENI 3
VULA DHE STEMA

Shoqata do të ketë stemën dhe vulën e saj të cilat do të shoqërojnë të gjithë dokumentacionin dhe publikimet e saj, në të cilat do të vendosen inicialet, emër dhe simboli i saj.

Simboli grafik i shoqatës do të jetë një krijesë me trup luani, bisht gjarpri dhe një kokë dhije të ngjitur në anë, bashke me banerin ku lexohet K.S Himara dhe togfjalëshi est.2025. Ngjyrat janë e kaltër dhe e bardhë.

NENI 4

SELIA DHE ZYRAT E PËRFAQËSIMIT

Selia e Shoqatës do të jetë në Himarë, pranë stadiumit "Petro Ruci", Himarë, me kod postar 9424.

NENI 5

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

Afati kohor i zhvillimit të veprimtarisë është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e shoqatës në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e së cilës ajo fiton personalitet juridik.

Shoqata, pasi të ketë fituar personalitet juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Personaliteti juridik i shoqatës mbaron në ditën kur vendimi i gjykatës për çregjistrimin e saj merr formë të prerë.

NENI 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

1. Të nxisë dhe të mbështesë veprimtaritë sportive profesioniste dhe amatore.
2. Organizimi i aktiviteteve sportive në rang kombëtar.
3. Krijimi i strukturave mbështetëse sportive për të gjitha grupmoshat.
4. Promovimi i aktiviteteve sportive dhe iniciativave për zhvillimin e sportit.
5. Mbrojtja e interesave dhe të drejtave të shoqatës.
6. Të synojë bashkëpunimin me shoqata të tjera të të njëjtit lloj.
7. Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatat Shqiptare të sporteve sipas disiplinave dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të sportit kombëtar dhe ndërkombëtar.
8. Futja në tregun e lojtarëve sipas nevojave të ekipit.
9. Aktivitete të tjera në fushën e sportit për interesat e Shoqatës dhe Bashkisë.

NENI 7

ZBATIMI I NORMAVE DHE RREGULLAVE TË ORGANIZMAVE KOMBËTAR DHE NDERKOMBËTARE TË SPORTIT

Gjatë përmbushjes së objektit të veprimtarisë së saj, shoqata respekton statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e Federatave Shqiptare dhe ndërkombëtare të sportit.

Me qëllim pjesëmarrjen në garat sportive kombëtare, shoqata detyrohet të plotësojë të gjitha kriteret e licencimit të përcaktuara nga organizmat përkatës të sportit.

Shoqata do të kryejë aktivitetin e saj vetëm pas pjesëmarrjes dhe në përputhje me licencat apo lejet përkatëse.

KAPITULLI II

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 8

ORGANET E SHOQATËS

Organet e shoqatës janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve;
- Bordi drejtues;
- Kryetari;

- Sekretari.

Të gjitha organet e zgjedhura të shoqatës qëndrojnë në detyrë për tre vjet dhe mund të rizgjidhen.

NENI 9

ORGANET VENDIMARRËS

Organi më i lartë vendimarrës i shoqatës është Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të saj.

Në mbledhjen e përgjithshme të asamblesë marrin pjesë themeluesi si anëtar i përhershëm, dhe anëtarët e tjerë të zgjedhur sipas procedurave të parashikuara më poshtë në këtë statut.

Në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligj ose në këtë statut, Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, mbledhet, madje edhe jashtë nga zyra qendrore, jo më pak se një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, si organi më i lartë vendimarrës i shoqatës, përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen prej tij, vendos për;

- Përcaktimin e programeve, iniciativave dhe orientimeve kulturore, shkencore dhe institucionale të shoqatës;
- Ndryshimin e statutit i cili realizohet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve themelues të shoqatës;
- Përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë;
- Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre;
- Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit;
- Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e organizatës jofitimprurëse dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm;
- Përcakton ekspertin auditues dhe shqyrton dhe miraton raportin e tij periodikisht;
- Përcakton nivelet e shpenzimeve si dhe tarifimet për shërbimet që do të kryejë.
- Zgjedh Kryetarin, zëvendës Kryetarin, Sekretarin dhe një përgjegjës për financën.

NENI 10

SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË ORGANIT MË TË LARTË VENDIMARRËS

Anëtarët e organit më të lartë vendimarrës, Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, si rregull ushtrojnë funksionin e tyre pa shpërblim.

Shoqata, në respektim të parimit të interesave më të mirë të shoqatës, në varësi të kushteve të saj, të numrit dhe të kohëzgjatjes së mbledhjeve, mund të rimbursojë shpenzimet në ushtrim të funksioneve dhe të shpërblejë në mënyrë të arsyeshme anëtarët më të lartë drejtues.

Numri i anëtarëve të organit më të lartë vendimarrës nuk mund të jetë më i vogël se 5.

NENI 11

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ANËTARËVE

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve lajmërohet me shkrim të paktën 15 ditë para.

Thirret nga Kryetari, i cili cakton programin dhe vendin.

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve mbledhet nga Kryetari dhe me kërkesën me shkrim të të paktën një të katërtës së anëtarëve në të gjitha rastet e parashikuara me ligj dhe në këtë statut.

Për vlefshmërinë e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, në të gjitha rastet është e detyrueshme prania e shumicës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Midis thirjes së parë dhe të dytë duhet të kalojë të paktën një orë.

Anëtari mund t'i japë me prokurë me shkrim një anëtar tjetër.

Çdo anëtar nuk mund të mbajë më shumë se dy funksione.

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve voton në mënyrë të hapur. Votimi për zgjedhjen e Kryetarit dhe argumente të tjera të një rëndësie të veçantë, lidhur me persona të veçantë mund të bëhet me votim të fshehtë.

Të gjitha ndryshimet miratohen me shumicë votash.

Çdo ndryshim në këtë statut do të vendoset nga një mbledhje e jashtëzakonshme e anëtarëve. Në këtë mbledhje të jashtëzakonshme duhet të jenë të pranishëm të paktën 2/3 e anëtarëve dhe të aprovohen me shumicë votash të atyre që janë të pranishëm.

Propozimet për ndryshime statutore duhet të vihen në rendin e ditës.

NENI 12

BORDI DREJTUES

Bordi Drejtues i Shoqatës zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.

Të gjithë anëtarët e shoqatës kanë të drejtë të barabartë për të votuar në zgjedhjet e anëtarëve të Bordit Drejtues.

Bordi Drejtues:

- Zgjidhet në çdo tre vjet me votë të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.
- Numri i anëtarëve të Bordit është 3 persona.
- Mblidhet të paktën dy herë në vit e thirrur nga Kryetari, i cili përcakton rendin e ditës së mbledhjes.

Mbledhjet e Bordit Drejtues janë të vlefshme kur janë ftuar të gjithë anëtarët dhe marrin pjesë në të më shumë se gjysma; vendimet merren me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Bordi Drejtues i shoqatës ka këto kompetenca:

- Përgatit projekt programin vjetor të aktiviteteve;
- Aprovon raportin vjetor të realizimit të detyrave të shoqatës;
- Cakton mënyrën e realizimit të të ardhurave të shoqatës;
- Vendos për ndryshimet që duhen bërë në shoqatë;
- Merr në shqyrtim dhe vendos mbi propozimet që bëhen nga organe dhe organizata të ndryshme me qëllim bashkëpunimi e ndihme të ndërsjellë;
- Diskuton çdo gjë të jashtëzakonshme që vihet në rendin e ditës së mbledhjes dhe merr vendime për sa i përket verifikimit të ekzistencës dhe të konfirmimit të vërtetësisë dhe përshtatshmërisë së çështjeve të paraqitura shoqatës nga anëtarët e rinj.

NENI 13

KRYETARI

- Zgjidhet për një periudhë tre-vjeçare nga anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, me të drejtë rizgjedhjeje.
- Punon për realizimin e udhëzimeve të përcaktuara nga Bordi Drejtues.
- Përfaqëson ligjërisht shoqatën para palëve të treta, dhe madje edhe në gjykatë.
- Nënshkruan dokumentet e shoqatës.
- Thërret dhe kryeson mbledhjet e Bordit dhe të Asamblese së Përgjithshme të Anëtarëve.
- Prezanton raportin vjetor në Asambleja e Përgjithshme të Anëtarëve.
- Kryetari mund të zëvendësohet në çdo kohë pa kushte.

- Zgjedhjet zhvillohen çdo tre vjet në muajin korrik. Në rastin e përfundimit të parakohshëm të funksionit, zgjedhjet do të zhvillohen në muajin e ardhshëm dhe do të përsëriten, çdo tre vjet në të njëjtin muaj.
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara me statut, nga Asambleja e Përgjithshme ose nga Bordi drejtues.

NENI 14

SEKRETARI

I zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve ndihmon kryetarin në veprimtarinë e tij të përditshme të punës dhe e zëvendëson atë në rast mungese në takime apo aktivitet të shoqatës.

KAPITULLI IV

ANËTARËSIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

NENI 15

ANËTARËSIMI NË SHOQATË

Anëtarësia në Shoqatë është e hapur për këdo i cili financon dhe paguan kuotat e anëtarësisë, pa marrë parasysh gjininë, ngjyrën, gjuhën, fenë, mendimin politik, prejardhjen sociale apo etnike, lidhjet me bashkësinë etnike, pronën apo lindjen.

Kohëzgjatja e anëtarësisë është për aq kohë sa anëtari paguan rregullisht kuotat e financimit në shoqëri. Asambleja e anëtarëve mund të vendosë që për financime madhore, anëtarit financues t'i japë të drejtë vetoe në vendimarrje për kohën që financon.

Anëtarët e Shoqatës kanë detyrim që t'u përmbahen rregullave të mëposhtme:

- Pranon statutin dhe programin e Shoqatës.
- Paguan kuotën e anëtarësisë.
- Trajton me respektin e duhur anëtarët e tjerë dhe stafin.
- Nuk përdor gjuhë abuzive dhe vulgare.
- Nuk lejohet që anëtari, ndërsa merr pjesë në aktivitet të Shoqatës, të jetë nën ndikimin e drogave të paligjshme dhe substancave të tjera halucinogjene.
- Nuk duhet kurrë të sjellë dëm ose të vjedhë ndonjë pronë që lidhet me veprimtarinë e Shoqatës.
- Nuk duhet kurrë të pijë duhan në mjediset e Shoqatës.
- Nuk duhet kurrë të përdorë gjuhë të keqe apo sjellje të pahijshme ndaj gjinisë së kundërt.

Anëtarë të Shoqatës janë edhe Kryetarët e Nderit të cilët mund të emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, duke pasur parasysh meritat e tyre të posaçme për zhvillimin e SPORTIT në Himarë.

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve pranon anëtarët e rinj të Shoqatës.

Në kërkesën për anëtarësim në shoqatë përcaktohet data e anëtarësisë, kuota si dhe një deklaratë ku kërkesi bie dakord të veprojë në përputhje me ligjin, statutin dhe rregullat e shoqatës. Anëtari i ri shënohet në librin e shoqatës. Anëtarësimi në shoqatë konsiderohet i kryer vetëm pas miratimit dhe pagesës së kontributit përkatës. Kuota vjetore e anëtarësisë përcaktohet me vendim të Bordit Drejtues. Çdo punë do të jetë mbi baza vullnetare dhe nuk ka anëtar ekzekutiv ose anëtar i Shoqatës që do të marrë pagesë prej saj. E drejta e anëtarësisë në Shoqatë nuk mund të tjetërsoset dhe as nuk mund të kalohet me trashëgimi.

NENI 16

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE TË SHOQATËS

Anëtari i shoqatës ka këto të drejta:

- Të marrë pjesë në veprimtaritë e shoqatës.
- Të kërkojë llogari para organeve drejtuese për punën e tyre.
- Të kundërshtojë në gjykatë vendimet e shoqatës që bien ndesh me ligjin ose me statutin.

Anëtari i shoqatës ka këto detyrime:

- Të zbatojë statutin dhe programin e shoqatës.
- Të paguajë rregullisht kuotizacionin.
- Të punojë për funksionimin normal të veprimtarisë së shoqatës.

NENI 17

DORËHEQJA

E drejta për të dhënë dorëheqjen është e garantuar, por me kusht që të jetë paraqitur me shkrim, tre muaj para, në një nga organet drejtuese të Shoqatës. Anëtarët që kanë dhënë dorëheqjen ose që janë përjashtuar nga Shoqata nuk kanë të drejta mbi kapitalin e Shoqatës. Anëtari i Shoqatës që jep dorëheqjen nuk shkarkohet nga detyrimet e tij ndaj Shoqatës në lidhje me pagesën e kontributeve, të cilat janë të pagueshme në kohën e paraqitjes së dorëheqjes.

NENI 18

PËRFUNDIMI I ANËTARËSISË

Anëtari mund të largohet nga Shoqata, atëherë kur i kryen të gjitha detyrimet financiare ndaj Shoqatës dhe anëtarëve të saj.

Anëtari jothemelues i ndërpret anëtarësinë në momentin që nuk financon për atë vit sportiv.

Konstatimi i ndërprerjes së anëtarësisë bëhet nga Bordi Drejtues dhe në rast ankimumi edhe nga Asambleja e anëtarëve.

Anëtari mund të përjashtohet nga Shoqata në rast se thyen dispozitat e Statutit dhe akteve të tjera normative të Shoqatës.

Vendimin për përjashtim e merr Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve dhe efektet e përjashtimit veprojnë nga dita e marrjes së vendimit.

Anëtari i shoqatës që nuk paguan plotësisht kontributin vjetor brenda 3 (tre) muajve të vitit pasardhës mund të përjashtohet nga shoqata, me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Një anëtar përjashtohet nga shoqata, përveç sa më sipër edhe për shkaqe të tjera të arsyeshme të cilat duhet t'i paraqiten atij me shkrim të paktën 20 ditë para, me qëllim që t'i krijohet mundësia anëtarit për t'u shprehur para Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve në lidhje me shkaqet që kanë sjellë propozimin për përjashtimin e tij.

Shkaqet e arsyeshme mbi bazën e të cilave mund të kërkohej përjashtimi nga shoqata i anëtarit të shoqatës (por që nuk janë të vetmet) konsiderohen sa më poshtë vijon:

- shkelja e dispozitave të statutit ose rregullave të tjera të shoqatës;
- mospagimi i detyrimeve që shkaktjnë përgjegjësinë e shoqatës;
- kryerja e veprimeve që bien në kundërshtim të hapur me normat etike të shoqatës;
- kryerja e veprimeve që dëmtojnë interesat e shoqatës.

Bordi Drejtues, në një takim të thirrur veçmas për këtë qëllim, do të trajtojë çdo shkelje të akteve nënligjore duke përdorur procedurën e mëposhtme:

- nxjerr një paralajmërim verbal;
- nxjerr një paralajmërim me shkrim;
- propozon përjashtimin e anëtarit nga Shoqata.

Në rast të një shkeljeje të rëndë, anëtari mund të përjashtohet pa i lëshuar asnjë vërejtje më parë.

KAPITULLI V

TË ARDHURAT, ADMINISTRIMI, LIKUIDIMI

NENI 19

TË ARDHURAT E SHOQATËS

Burimet financiare dhe materiale të Shoqatës janë:

1. Kuotizacionet e anëtarëve.
2. Mbështetje financiare nga shteti, Bashkia dhe Shoqëritë Aksionere me ortak të vetëm Bashkinë Himarë.
3. Mbështetje financiare nga Federatat Shqiptare.
4. Mbështetje financiare nga federatat ndërkombëtare dhe federate të tjera homologe.
5. Grante, donacione dhe sponsorizime të ofruara nga subjekte private dhe publike, vendas dhe të huaj.
6. Të ardhura nga reklamat.
7. Të ardhura nga veprimtaria ekonomike në përputhje me ligjin, sipas miratimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve.
8. Të ardhura nga pasuritë në pronësi të Shoqatës.
9. Burime të tjera të ligjshme financiare.

Shoqata ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të lëvizshme apo të palëvizshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe qëllimin e shoqatës, të parashikuar në statut. Të ardhurat e realizuara nga shoqata duhet të përdoren vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohet si qëllim dhe objektiv i saj në aktin e themelimit dhe statut.

NENI 20

KRITERET E ADMINISTRIMIT TË PASURISË

Administrimi i pasurive të Shoqatës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e organeve drejtuese të saj.

Për të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe financiare mbahet bilanc i rregullt që miratohet nga Asambleja e Përgjithshme të Anëtarëve.

Shoqata ka llogaritë e saj bankare që hapen dhe operojnë sipas urdhërave të Kryetarit të saj.

Organet drejtuese dhe donatorët e mundshëm kanë të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shpjegime rreth gjendjes financiare të shoqatës dhe personi përgjegjës i jep ato brenda një afati optimal. Nëse është e nevojshme këto shpjegime shoqërohen me fotokopiet e dokumentacionit përkatës. Administrimi financiar i Shoqatës kryhet nga Kryetari në bazë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve dhe planit financiar të miratuar nga ky organ. Për ndihmë në realizimin e administrimit të Shoqatës mund të punësohet referenti financiar, në përputhje me ligjin mbi marrëdhëniet e punës. Kryetari do të mbajë të dhënat financiare dhe së bashku me financierin do të mbajë kontaktet me bankën. Financieri është përgjegjësi kryesor i buxhetit të Shoqatës. Do të ketë auditim të rregullt të llogarive dhe pasqyrave financiare të Shoqatës. Financieri është gjithashtu përgjegjës, së bashku me Kryetarin, për llogarinë bankare dhe do të konfirmojë çeqet e lëshuara. Të gjitha donacionet dhe shpenzimet e Shoqatës do të jenë të publikuara për akses nga të gjithë.

NENI 21

PERDORIMI I TË ARDHURAVE TË DISPONUESHME TË SHOQATËS

Shoqata siguron të ardhura nga fondet që janë të njohura nga ligji dhe kryen vetëm shpenzime për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë.

Aktivitetet e Shoqatës bazohen dhe në punën vullnetare të anëtarëve të saj dhe nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit për ta.

NENI 22

MARRËDHËNIET ME DONATORËT

Marrëdhëniet financiare, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella me donatorët realizohen në përputhje me marrëveshjet përkatëse, por duke respektuar kërkesat e statutit dhe të ligjit.

Ndaloben ndihma materiale ose financiare që jepen për qëllime të kundërligjshme ose që sigurohen nëpërmjet burimeve të kundërligjshme.

NENI 23

VEPRIMTARIA EKONOMIKE

Shoqata, për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së saj, sipas ligjit, ka të drejtë të ushtrojë veprimtari ekonomike.

Shoqata, mund të zhvillojë veprimtari ekonomike pa qenë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për këtë qëllim, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e saj, të jetë deklaruar si e tillë nga burimet e të ardhurave dhe me kusht që kjo veprimtari të mos përbëjë qëllimin primar të veprimtarisë së organizatës.

Nëse Shoqata nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë ekonomike realizon fitime, ato duhet të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe me aktin e themelimit.

NENI 24

PËRFAQËSIMI LIGJOR

Përfaqësues ligjor i Shoqatës është Kryetari i saj.

NENI 25

RREGULLAT PËR BASHKIMIN DHE NDARJEN

Bashkimi i Shoqatës me ndonjë subjekt tjetër jofitimprurës ose rindarja në veçanti bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, gjithmonë duke zbatuar kërkesat e Kodit Civil dhe akteve ligjore në fuqi.

NENI 26

SHPËRNDARJA E SHOQATËS

Shoqata shpërndahet me iniciativën e saj, kur këtë e kërkojnë më shumë se 3/4 e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve. Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme cakton një ose disa likuidatorë të cilët realizojnë likuidimin e shoqatës.

Asambleja e Përgjithshme vendos edhe për destinacionin ku shkon pasuria e mbetur e shoqatës.

Kur shpërndarja e shoqatës nuk arrihet nga vetë shoqata kompetente është Gjykata, e cila cakton një ose disa likuidatorë të cilët bëjnë likuidimin e saj.

NENI 27

SHPËRNDARJA ME VENDIM GJYKATE

Gjykata mund të vendosë shpërndarjen e Shoqatës, me kërkesë të anëtarëve të saj, të organeve të saj vendimarrëse, të organit shtetëror kompetent në rastet kur:

☐ Veprimtaria e saj vjen në kundërshtim me Kushtetutën.

- ☐ Kryen veprimtari të kundërligjshme.
- ☐ Nuk është themeluar sipas kërkesave të ligjit.

NENI 28

LIKUIDIMI

Likuidatori bën vlerësimin e gjendjes financiare të shoqatës dhe pasurisë së saj në momentin e vendimit për shpërndarjen e saj dhe evidenton të gjithë kreditorët dhe debitorët e mundshëm. Pas pagimit të detyrimeve që Shoqata mund t'u ketë të tretëve, likuidatori bën vlerësimin e pasurisë së mbetur dhe kujdeset që kjo pasuri të shkojë sipas destinacionit të përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme të Anëtarëve.

NENI 29

TË TJERA

Ky statut u përgatitet në 5 (Pesë) kopje origjinale, nga 9 fletë secili, në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë ligjore, për përmbajtjen e të cilit anëtarët kanë rënë dakord dhe zotoben për zbatimin me besnikëri të tij.

ANËTARËT THEMELUES (emrat dhe firmat e tyre).

ANËTARËT THEMELUES (emrat dhe firmat e tyre)

1. Z. Vangjel Tavo, Kryetari i Bashkisë. _____
2. Znj. Erifili Berberi, Nënkryetar i Bashkisë. _____
3. Z. Pervin Gjiguria, Sekretar i Përgjithshëm. _____
4. Znj. Besa Xhaferi, Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Planifikimit të Buxhetit. _____
5. Z. Uran Dulaj, Drejtor i Drejtorisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit. _____
6. Z. Thimjo Gjinuci, Administrator i Njesisë Administrative Himarë. _____

